



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME E NDËRTIMIT “KARL GEGA” TIRANË**

Nr. 266 Prot.

Tiranë, më 08 /09/2025

Lënda : Njoftim për vend të lirë pune

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore

DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit Nr.15 datë 16.02.2017 , “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr 554 date 31.07.2019 “ Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjensisë Kombëtare të Punesimit dhe Aftësive (AKPA) , Udhëzimt të MFE, Nr.25, datë 01.09.2023 nr 15702 prot “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet arsimit profesional” Udhëzimt të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Nr.759, datë 30.09.2024 “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË, MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJEN E NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË INSTITUCIONEVE, OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT” , Udhëzimi i Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 4, datë 18.8.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 759, datë 30.9.2024neni 135 dhe 136 pika 5 .ofruesi publik i AFP-së. Shkolla e mesme e ndërtimit “Karl Gega”, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

1- Specialist I burimeve njerëzore/jurist – 1 (Një)

Aplikanti duhet të përmbushë këto kritere të përgjithshme dhe të posaçme .

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2. Kritere të posaçme për specialistin e burimeve njerëzore/juristit:

- a) të ketë të paktën nivelin arsimor Bachelor, në shkenca shoqërore/juridike në shpalljen për pozicionin përkatës;
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit publik të AFP-së, brenda datës ...17.09.2025

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

Konceptoi: B. Shehaj

Pranoi: F. Selimja

Miratoi: I. Gorçe

Konfirmoi: I. Gorçe

